

Credins Bank ofron për cdo klient një eksperiencë bankare digjitale me aplikacionin Credins Online

Bankingu online në vendin tonë po fiton gjithmonë e më shumë peshë krahasuar me bankungun tradicional. Zhvillimet e shpejta të teknologjisë i kanë dhënë mundësinë sektorit bankar që tu ofrojë klientëve një eksperiencë të mirë përmes kanaleve digjitale. Si një nga bankat më të mëdha në vend dhe me një rol të rëndësishëm në sektorin bankar Banka Credins sigurisht që do të ruante pozicionin e saj edhe në fushën e shërbimeve digjitale. Credins Online, është platforma që banka Credins sjell për klientët e saj, duke u ofruar atyre një eksperiencë digjitale unike.

Credins Online vjen si një produkt i zhvillimit të vazhdueshëm dhe investimeve që banka ka kryer, në përputhje me strategjinë e saj për zhvillimin e inovacionit dhe zgjerimin e kanaleve digjitale. Objektivi i bankës Credins është jo vetëm

ofrimi i sa më shumë shërbimeve bankare përmes platformës digjitale, por edhe sjellja e këtyre shërbimeve tek klienti në mënyrë sa më të thjeshtë dhe intuitive. Që kur platforma i është ofruar klientëve të saj, Credins Online ka sjellë vazhdimisht risi dhe zhvillime të reja. Credins Online është një platformë me design modern,

i thjeshtë në përdorim, i shpejtë, me shumë funksionalitete të përshtatura sipas nevojave të klientëve dhe me një siguri maksimale, 24 orë në dite, në 7 ditë të javës. Krahas zhvillimit të platformës, banka Credins i është dedikuar dhe suportit të klientëve në



**JUXHIN
HAXHIJA**

**Përgjegjës i Sektorit E-Banking,
Departamenti i Informatikës**

përdorimin e shërbimeve digjitale. Sektori E-banking është krijuar si strukturë e veçantë, dedikuar zhvillimit të platformës dhe suportit të menjëhershëm të përdoruesve të aplikacionit, jo vetëm online, por dhe me konsultimin me klientët tanë në degë apo dhe në ambientin ku operon biznesi.

Pandemia COVID 19 ishte një sfidë e madhe si për të gjithë sektorët ashtu edhe për sektorin bankar. Kufizimet fizike bënë që klientët ta kthejnë vëmendjen drejt shërbimeve digjitale. Me Credins Online mund të themi se banka Credins e përballoi me

sukses këtë sfidë, duke u ofruar klientëve mundësinë për të kryer shërbimet bankare në mënyrë të pandërprerë. Përveç funksionaliteteve, te nje game te gjere, që ofroheshin prej kohësh në platformë, si kryerja e transfertave brenda dhe jashtë vendit, pagesat e faturave utilitare apo pagesa e tatimeve dhe taksave,

doganave, konvertimit me kurse preferenciale, të gjitha të ofruara në kohë reale me kushte preferenciale, klientëve ju shtuan dhe disa shërbime të tjera të cilat i erdhën në ndihmë në përputhje me situatën.

Një nga zhvillimet kryesore, që erdhi pikërisht në këtë periudhë, si ndihmesë shumë e madhe për klientët, por njëkohësisht edhe si risi në shërbimet bankare digjitale në Shqipëri ishte hapja e llogarisë rrjedhëse dhe hapja e depozitës pa afat online. Çdo klient i bankës, që e ka një produkt aktiv në bankë mund të çelë një llogari rrjedhëse, përmes Credins Online nga celulari apo kompjuteri i tij, pa qenë e nevojshme të paraqitet në një degë të bankës dhe këtë llogari e ka aktive në moment dhe mund ta përdorë menjëherë po nga Credins Online. Një tjetër shërbim, që ju përgjigj në kohë kërkesës së klientëve ishte mundësia për ndryshimin e të drejtave të përdorimit të llogarive online. Pra, të gjithë ata klientë ekzistues, që më parë e përdornin platformën online vetëm për vështrimin e balancës së llogarive të tyre apo për historikun e veprimeve, ju dha mundësia që të ndryshojnë vetë aksesin e llogarive duke e bërë atë me të drejta të plota, për të bërë të mundur kështu kryerjen e transfertave apo pagesave të ndryshme. Zhvillime të tjera pasuruan platformën dhe produkte të tjera u ofrohen klientëve përmes Credins Online si rimbushja e një karte prepaid apo kartave të tjera, etj.

Në fillim të vitit 2021, një tjetër risi është hapja e kartës së debitit online. Çdo klient, që ka një llogari rrjedhëse dhe dëshiron të lidhë një kartë debiti me të, mund të apollikojë online duke zgjedhur kartën që dëshiron dhe më pas klienti do të njoftohet kur karta është gati. Një shërbim tjetër që lidhet me kartat është bllokimi dhe zhblllokimi i kartave online përmes platformës, duke i dhënë kështu klientit më tepër kontroll në produktet e veta dhe duke e bërë përdorimin e tyre

më të sigurt. Gjithashtu u shtuan edhe disa shërbime të tjera, që i japin mundësinë klientit të aplikojë online për produktet që banka ofron, siç janë aplikimi për overdraft apo për kredi.

Investimet e vazhdueshme që banka ka bërë vitet e fundit për përmirësimin e infrastrukturës dhe platformës së saj online, mbështetja e drejtuesve të lartë, që në fokus kryesor të strategjisë kanë pasur zhvillimin e shërbimeve digjitale, shtimi i interesimit të klientëve për bankungun digjital ishin faktorët kryesorë që sollën rezultate shumë pozitive si në rritjen e numrit të klientëve dhe në rritjen e përdorueshmërisë së shërbimeve online. Këto rezultate mjaft inkurajuese janë ato që na bëjnë akoma më të vendosur për të vazhduar akoma më tej zgjerimin e gamës së shërbimeve digjitale, për të plotësuar nevojat e klientëve.

Konkretisht, Credins Online pati një rritje në vitin 2020 të numrit të përdoruesve me 62% krahasuar me vitin 2019. Llogaritë e aksesueshme nga interneti shënuan një rritje me 45% në 2020. Rritje ka patur edhe në numrin e transaksioneve ku pagesat e faturave utilitare shënuan një rritje me 164% krahasuar me vitin 2019, ndërsa transfertat brenda dhe jashtë vendit u dyfishuan dhe numri total i transaksioneve u rrit me 88%.

Shumë shpejt Credins Online do të ofrojë produkte dhe shërbime të reja për klientët e saj, duke synuar realizimin e objektivit të bankës, që çdo shërbim që ofrohet në sportelet e saj dhe që është në përputhje me rregulloret në fuqi në vendin tonë, të mund të ofrohet edhe në kanalin digjital.

Credins Online, po bëhet gjithnjë e më shumë një kanal i pavarur në ofrimin e shërbimeve bankare tek klienti, duke i dhënë mundësinë që përmes celularit apo kompjuterit të ketë bankën në dorën e tij, pa qenë e nevojshme prania në një degë të bankës.